



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 52/09**

**Prishtinë, më 1.06.2009, ora 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa**

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Besa Gaxherri, Müfera Şinik, Haki Shatri, Riza Smaka, dhe Shkumbin Demaliaj.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Lulzim Ismajli - Drejtor i Thesarit pranë MEF, Agim Krasniqi - Drejtor i Buxhetit pranë MEF-it, Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit, Teki Shala nga NDI, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, ICO, KDI.**

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit tre mujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tre mujorin e parë të vitit 2009;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar dhe Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi,** njoftoi se pika e katërt e rendit të ditës, nuk do të jetë objekt diskutimi, sepse Projektligji është miratuar në Kuvend me procedurë të përsheptua dt. 29.04.2009.

Rendit ditës miratohet me ndryshime, heqjet nga diskutimi e pikës së katërt të rendit të ditës.

## 2. Shqyrtimi i Raportit tre mujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009

**Kryesuesi**, ia dha fjalën drejtorit të Thesarit për të dhënë informata më të shumta rreth raportit.

**Lulzim Ismajli - Drejtor i Thesarit pranë MEF**, njoftoi se raporti është përgatitur në përputhje me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligjit për ndarjet buxhetore dhe i njëjti është në përputhje me standartet ndërkombëtare të kontabilitetit. Nga të dhënat e prezantuar shifet se gjatë kësaj periudhe janë realizuar të hyra në vlerë prej 187.60 milion € (19.6% ndaj progresit të buxhetit 2009 dhe 9.3 % më të larta se 2008), ndërsa shpenzimet në vlerë prej 162.25 milion € (13.9 % progres 2009, ndërsa 28.2% më të larta se 2008). Sipas strukturës të hyrat e grumbulluara në kufij paraqesin 61 %, që kanë shënuar rritje prej 7.1 % krahasime me periudhën paraprake, të hyrat nga ATK-ja janë 32.9 % më të larta se në periudhën paraprake, të hyrat nivelin qendror 7% më tepër se periudha paraprake, të hyrat jotatimore në nivelin qeveritar 21.1%, që paraqesin zvogëlim prej minus 35 %, të hyrat vetanake komunale janë realizuar 22.5 %, paraqesin rritje prej 28% krahasuar me periudhën paraprake. Sa i përket shpenzimeve, kemi rritje të pagave dhe mëditjeve (si rezultat i krijimit të institucioneve të reja, ngritja e pagave për mësimdhënësit dhe rritja e pagave të shërbyesve civil), mallrat dhe shërbimet janë realizuar 12.8 % më tepër se periudha paraprake, shpenzimet komunale 16.8%, subvencioneve 18.5 %. Sa i përket shpenzimeve kapitale, nëse zbriten transferet kapitale për ndërmarrjet publike, kemi rrije prej 115%.

**Kryesuesi**, kërkoi sqarim për shpenzimet kapitale, që kanë shënuar progres vetëm 1.3% ndaj planit.

**Agim Krasniqi**, duke u përgjigjur parafolësit, theksoi se për dallim prej shpenzimeve tjera që janë mujore, shpenzimet kapitale në tre mujorin e parë, për shkak të procedurave, paraqesin vetëm fillimin e procesit të realizimit të këtyre shpenzimeve kapitale.

**Haki Shatri**, theksoi se të dhënat në raport janë paraqitur ashtu siq ka ndodhur gjatë kësaj periudhe. Materiali i plotëson kriteret ligjore për procedim në Kuvend. Megjithatë bëri vërejtje për shumën të larta të pambyllura të avanceve për udhëtime zyrtare. Theksoi se Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të duhej që konform ligjit t'i kushtëzoj organizatat buxhetore që ti mbyllin ato.

**Besa Gaxherri**, bëri vërejtje për rritjen e pagave dhe mëditjeve. Është rritur numri i punëtorëve në administratën publike. Po ashtu edhe shuma e avanceve të pambyllura është e lartë. Sa i përket shpenzimeve kapitale përkundër procedurave, realizimi i tyre në shuma të vogla gjatë kësaj periudhe është i papranueshëm. Ato gjithmonë po lehen në tre mujorin e fundit të vitit. Kërkoi sqarim për përshkrimin "kapital tjetër" në vlerë prej 1,458,234 € i paraparë në kategorinë shpenzime kapitale.

**Riza Smaka**, vlerësoi raportin mirë të përgatitur, i cili prezanton gjendjen faktike. Megjithatë bëri vërejtjet lidhur me avanset dhe rritjen e numrit të punëtorëve. Sa i përket avanceve theksoi se Ministria duhet që me akt nënligjor të rregulloj këtë çështje, në të cilën do të përfshiheshin edhe sanksionet. Ndërsa vlerësoi punë të mirë rritjen e të hyrave nga kundërvajtjet. Në kategorinë mallrat dhe shërbimet, kërkoi sqarime për përshkrimin shpenzimet – vendimet e gjykatave, si dhe sqarime për përshkrimin pagesa-vendime gjyqësore, të paraparë në kategorinë shpenzime komunale.

**Myrvete Pantina**, vlerësoi raportin përmbajtësor. Veçanarisht vlerësoi rritjen e të hyrave nga ATK-ja. Ndërsa bëri vërejtje për rritjen e numrit të punëtorë, avancet e pambyllura, për shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzimet e marketingut. Gjithashtu janë rritur subvencionet dhe transferet në të gjitha kategoritë.

**Lulzim Ismajli - Drejtor i Thesarit pranë MEF**, në përgjigjen e pyetjeve, theksoi se sa i përket avanceve kjo çështje është e rregulluar me udhëzim administrativ nga Ministria e Shërbimeve Publike, dhe në konform kësaj kemi kërkuar mbylljen e tyre (shumica e tyre janë në Ministrinë e Jashtme). Në këtë drejtim janë duke u përgatitur kartelat bankare për zyrtarët më të lartë të vendit. Sa i përket shpenzimeve kapitale, që janë më ultra në krahasim me periudhën paraprahe, kjo për arsye se vitin e kaluar ka pasur transfere për ndërmarrjet publike. Përshkrimi kapital tjetër është shuma e mirëmbajtjes së rrugëve (shenjat e rrugëve). Subvencionet janë rritur si rezultat i rritjes së pensioneve dhe ndihmave sociale. Sa i përket pyetjes për vendimet e gjykatave, kemi të bëjmë me të hyrat nga vendimet e formës së prerë që i shqiptojnë gjykatat.

**Kryesuesi**, theksoi se raporti përmbush kushtet ligjore për raportim dhe nga përmbajta e tij shifet një përfomancë e mirë e të hyrave dhe shpenzimeve, nga ajo që është planifikuar dhe realizuar. Krahasuar me periudhën e vitit të kaluar, ka lëvizje shumë pozitive, që është për tu vlerësuar.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni konstatoi se Raporti tre mujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, i plotëson standartet ligjore të kontabilitetit për raportim dhe bazohet në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
- II. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që raportin ta miratojë në seancën plenare.

### **3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tre mujorin e parë të vitit 2009**

**Kryesuesi**, për të dhënë informata më të shumta rreth raportit, ia dha fjalën sekretarit të Kuvendit.

**Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit**, theksoi se gjatë periudhës tre mujore kemi shpenzim më të madh për paga dhe mëditjeve për shkak të miratimit me vonesë të buxhetit. Udhëtimet zyrtare paraqesin shpenzime më të larta, ndërsa shpenzimet komunale janë standarte. Sa i përket shpenzimeve kapitale ato nuk janë realizuar, për shkak të problemeve me miratimin e buxhetit si dhe procedurave ekzistuese në këtë periudhë për realizimin e tyre. Ndërsa gjatë tre mujorit të dytë kemi lëvizje pozitive në këtë drejtim, me përjashtim të projektit “Villa Gërmija”. Nga ky projekt është menduar që të merren disa mjete dhe përmes kërkesës buxhetore në rishikim të buxhetit do të kërkohej që të transferohen për nevoja të ndërtesës së Kuvendit (rregullimi ujësjellësit, kanalizimit, dyerve dhe dritareve). Mjete të parapara për anekset ku janë të vendosura dy Ministrinë, do të transferohen në renovimin e dy sallave për nevoja të komisionit.

**Besa Gaxheri**, theksoi se jo vetëm për këta tre muaj por edhe vitin e kaluar, mos realizimi i investimeve kapitale është i papranueshëm, janë realizuar vetëm 28 %. Do të duhej Kuvendi të rregulloj çështjen administrative të objektit “Villa Gërmija, duke pasur parasysh nevojën si dhe vendimi i Kuvendit për vazhdimin e punës në këtë objekt. Sa i përket realizimit të investimeve të Kuvendit, jemi treguar shumë inert.

**Kryesuesi**, raporti konform standarteve të raportimit. Duke ditur problemet në realizimin e investive kapitale, do të kërkohej nga Kryesia e Kuvendit të ndërmerret diçka në drejtim të realizimit të këtyre

investimeve. Sa i përket nevojave të Kuvendit, duke i pasur parasysh edhe kërkesën e divizionit të sigurimit, do të shqyrtohen në rishikim të buxhetit, pa ndryshuar vijat buxhetore.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tre mujorin e parë të vitit 2009 i plotëson standartet ligjore të kontabilitetit për raportim.
- II. Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 të zbatohet sipas Ligjit nr.03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, sidomos në kategorinë ekonomike paga dhe medijtje.
- III. Nevojat eventuale të Kuvendit për vitin 2009 të paraqiten për shqyrtim në kërkesën buxhetore me rastin e procesit të rishikimit të buxhetit për vitin 2009.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

**Përgatitur nga**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

---

**Gani KOCI**